



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

Nr. 1163/1 Prot.

Tiranë, më 13.10.2020

UDHËZUES

MBI

**PËRDORIMIN E DETYRUESHËM TË MASKAVE NË AMBJENTET JASHTË
SHTËPISË**

Ky Udhëzues, hartohet bazuar në pikën 23 të Aktit Normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar.

HYRJE

Ky dokument paraqet kriteret e përgjithshme, rregullat dhe përjashtimet për përdorimin e barrierave mbrojtëse (maskave) në ambjentet jashtë shtëpisë, me qëllim zvogëlimin e përhapjes së mundshme të COVID-19.

Maska ndihmon në zvogëlimin e përhapjes së infeksionit në komunitet duke minimizuar transmetimin e tij nga individë të infektuar. Përdorimi i maskave të fytyrës në komunitet mund të shërbejë si një mjet për kontrollin e burimit të infeksionit.

Përdorimi i barrierës mbrojtëse (maskës) duhet të konsiderohet vetëm si një masë plotësuese dhe jo si një zëvendësim i masave të përcaktuara parandaluese, duhet të zbatohet bashkë me distancën fizike 1.5-2 metra dhe higjienën e duarve.

1. PËRDORIMI KORREKT I BARRIERËS MBROJTËSE (MASKËS)

Parimet e përdorimit korrekt të maskave janë:

- a. Maska e fytyrës duhet të mbulojë plotësisht hundën, gojën dhe mjekrën.
- b. Pastrohen duart me sapun dhe ujë ose desinfektues duarsh me bazë alkooli përpara se të vendoset dhe hiqet maska.
- c. Maska nuk duhet të preket kur vendoset.
- d. Maska duhet të hiqet nga pas, duke shmangur prekjen e përparme të saj duke palosur qoshet e jashtme sëbashku.
- e. Maska kirurgjikale hidhet në koshin e mbetjeve pas heqjes.
- f. Lani duart ose përdorni desinfektant menjëherë pas heqjes së maskës.
- g. Maska jo mjekësore prej tekstili, e ripërdorshme pasi hiqet duhet të lahet pas çdo përdorimi, duke përdorur larës të zakonshëm në 60° C.
- h. Maska jo mjekësore prej tekstili pasi të hiqet vendoset në një qese deri sa të lahet.

2. KUR DUHET TË MBAHET MASKA

COVID-19 përhapet kryesisht ndërmjet njerëzve që janë në kontakt të ngushtë me njëri-tjetrin (brenda 1.5-2 metra). Barriera mbrojtëse (maska) duhet patur gjithmonë me vete. Përdorimi i barrierës mbrojtëse (maskës) jashtë shtëpisë rekomandohet parimisht në këto raste:

- a. Sa herë dilni nga shtëpia;
- b. Fëmijë mbi moshën 11 vjeç;
- c. Gjatë të gjithë ditës gjatë të gjithë veprimtarisë jashtë banesës.
- d. Në çdo dyqan, supermarket apo aktivitet tregtar
- e. Në të gjitha mjetet e transportit publik dhe jo publik kur në to gjenden persona të tjerë përveç drejtuesit të automjetit.
- f. Edhe gjatë ecjes në rrugë
- g. Gjatë qëndrimit në të gjitha vendet publike të hapura si park apo shesh
- h. Gjatë të gjithë aktivitetit të punës në zyra, të gjithë institucionet publike dhe jo publike, teatër, kinema, muze, biblioteka, etj

- i. Në hyrje dhe dalje nga banesa si dhe ashensorë
- j. Përpara dhe pas konsumit të ushqimit në bare dhe restorante
- k. Në motoçikletë kur merr një person tjetër jo anëtare të familjes
- l. Nëse jeni duke u kujdesur në shtëpi për një familjar me COVID-19
- m. Në të gjitha institucionet fetare.
- n. Nga personat që e kanë kaluar SARS COV -2 për t'u mbrojtur nga shkatarët e tjerë infektivë respiratorë.
- o. Në institucionet arsimore dhe ato të kujdesit shëndetësor sipas rekomandimeve të mëparshme.

3. MODIFIKIMET E PËRDORIMIT TË BARRIERËS MBROJTËSE MASKËS

Vendosja e barrierës mbrojtëse (maskës) nuk mund të jetë e mundur në çdo situatë. Prandaj, ekzistojnë gjithashtu skenarë në disa raste kur ju lejohet të hiqni atë apo të modifikoni përdorimin e saj:

- a. Nëse kërkohet për qëllime të identifikimit personal nga zyrtarët përkatës në polici, në bankë, postë, gjykatë, etj
- b. Gjatë ngrënies apo konsumimit të pijeve por në hyrje e në dalje nga baret dhe restorantet maska duhet të vendoset.
- c. Gjatë procesit të manipulimeve dentare por në hyrje e në dalje nga klinika maska duhet të vendoset.
- d. Nga personat që mbajnë/drejtojnë lutjen/shërbesën/veremoninë fetare
- e. Nga persona me humbje të dëgjimit dhe të folurit ose për personat gjatë kohës së komunikimit me ta, nëse nuk kanë mundësi të përdorin maska të posaçme (transparente).
- f. Nëse kërkohet nga stafi i dyqaneve ose marketeve përkatëse për identifikim të moshës, përfshirë blerjen e produkteve me moshë të kufizuar, siç janë duhani dhe alkooli
- g. Nga punëtorët që punojnë në ambjente të jashtme, gjatë procesit të punës kur sigurohet distance fizike jo më pak se 1.5m.
- h. Nga të ftuarit në emisionet televizive me kusht që të ruhet distanca jo më pak se 1.5 metra.

4. RASTET PËRJASHTIMORE TË PËRDORIMIT TË BARRIERËS MBROJTËSE (MASKËS)

Mbajtja e maskës nuk mund të jetë e mundur në çdo situatë, prandaj parashikohen situatat përjashtimore si vijon:

- a. Në të gjitha rastet kur përdorimi i maskës dëmton shëndetin sipas rekomandimit të mjekut të familjes*).
- b. Nga persona me sëmundje që i bëjnë të paafte për përdorimin maskës*).
- c. Gjatë ushtrimit të aktiviteteve sportive.
- d. Nga persona të cilët lëvizin të vetëm me biçikletë, motoçikletë apo monopatinë.
- e. Kur në makinë është vetëm drejtuesi i mjetit ose persona që kanë lidhje familjare me të
- f. Në aktivitete që mund të shkaktojnë lagjen e maskës, si p.sh. gjatë larjes në pishinë, liqe ose në det.
- g. Në shtëpi me anëtarët e ngushtë të familjes.

* Atyre që për shkak të moshës, shëndetit ose për arsye të paaftësisë nuk bartin maskë, do t'u kërkohet dokumentacioni shëndetësor që verifikon statusin aspo vërtetimi respektiv.

***Këto udhëzime do të rivlerësohen në vazhdim sipas të dhënave sëmundshmërisë dhe situates epidemiologjike të COVID-19.*

****Udhëzuesit e mëparshëm mbi përdorimin e maskës që nuk bien ndesh, mbeten në fuqi.*

DREJTOR

Albana FICO



Referencat

1. National Institute for Occupational Safety and Health (NIOSH). Use of respirators and surgical masks for protection against healthcare hazards [internet]. Atlanta: CDC; 2018 [accessed 1 April 2020]. Available from:
[https://www.cdc.gov/niosh/topics/healthcarehsp/respiratory](https://www.cdc.gov/niosh/topics/healthcarehsp/respiratory.html) .html 2.
2. European Centre for Disease Prevention and Control (ECDC). Safe use of personal protective equipment in the treatment of infectious diseases of high consequence. Stockholm: ECDC; 2014. Available from:
<https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/media/en/publications/Publications/safe-use-of-ppe.pdf>
3. World Health Organization (WHO). Non-pharmaceutical public health measures for mitigating the risk and impact of epidemic and pandemic influenza. Geneva: WHO; 2019. Available from:
<https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/329438/9789241516839-eng.pdf>
4. World Health Organization. Advice on the use of masks in the context of COVID-19. Geneva: World Health Organization; 2020 (<https://apps.who.int/iris/handle/10665/331693> accessed 20 August 2020)
5. UNICEF. Convention on the Rights of the Child text. 1990 (<https://www.unicef.org/child-rights-convention/conventiontext> accessed 20 August 2020).
6. CDC, USA: www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/prevent-getting-sick/how-to-wear-cloth-face-coverings.html